

Bazuar në nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 59/25") dhe nenit 5 paragrafit 1 nga Rregullorja për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve, nr. 01-440/3 datë 28.12.2022, nr. 01-176/3 datë 1.3.2023, nr. 01-197/3 datë 15.04.2024, nr. 01-109/3 datë 11.02.2025 dhe nr. 01-157/4 datë 25.3.2025, Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall

KONKURSI PUBLIK I PËRSËRITUR

për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - përkthyes dhe lexues të pavarur

I. Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall konkurs të përsëritur publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - përkthyes dhe lexues të pavarur për nevojat e maturës shtetërore, si vijon:

a) përkthyes të materialit të provimit për nevojat e maturës shtetërore:

- 1) Matematikë – 1 (një) përkthyes nga gjuha maqedonase në gjuhën turke dhe anasjelltas;
- 2) Gjuhë shqipe dhe letërsi – 1 (një) përkthyes nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe dhe anasjelltas dhe
- 3) Estetikë – 1 (një) përkthyes nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

b) lexues i pavarur i materialit të provimit për nevojat e maturës shtetërore:

- 1) Gjuhë Turke dhe Letërsi – 1 (një) lexues i pavarur.

II. Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët në konkursin publik:

a) Kandidatët që konkurrojnë për përkthyes të materialit të provimit për nevojat e maturës shtetërore, duhet të plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të kryer të paktën studimet akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse;
- të jenë nga radhët e mësimdhënësve të lëndës përkatëse mësimore në shkollat e mesme në RMV ose nga radha e kuadrit arsimor-shkencor ose profesional nga universitetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut për lëndën përkatëse, përkatësisht fusha përkatëse;
- të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune në mësimdhënie;
- të jenë njohës të shkëlqyer të gjuhës burimore (gjuhës nga e cila përkthehet materiali) dhe të gjuhës së synuar (gjuhës në të cilën po përkthehet materiali).

b) Kandidatët që konkurrojnë për lexues të pavarur të materialit të provimit për nevojat e maturës shtetërore, duhet të plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të kryer të paktën studime akademike të ciklit të dytë nga fusha përkatëse;
- të jenë nga radhët e kuadrit arsimor-shkencor ose profesional nga universitetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga lënda përkatëse, përkatësisht fusha përkatëse;
- të kenë të paktën 5 vjet përvojë pune në veprimtari edukativo-arsimore ose shkencore;

- të kenë të publikuara punime profesionale, përkatësisht punime shkencore që janë në funksion të fushës përkatëse.

III. Kandidatët detyrimisht e dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kandidatët për **përkthyes**, duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- fletëparaqitje (formulari i vendosur në ueb-faqen: www.dic.edu.mk);
- certifikatë të shtetësisë;
- një kopje të certifikatës/diplomës së arsimit të lartë përkatës dhe
- certifikatë në origjinal e punësimit të rregullt dhe përvojë pune përkatëse prej të paktën 3 vjetësh si mësimdhënës i lëndës përkatëse, lëshuar nga shkollat e mesme në RMV ose si pjesë e kuadrit mësimor-shkencor ose profesional nga universitetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut për lëndën përkatëse, përkatësisht fushën përkatëse, lëshuar nga universitetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

b) Kandidatët për **lexues të pavarur**, duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- fletëparaqitje (formulari i vendosur në ueb-faqen: www.dic.edu.mk);
- certifikatë të shtetësisë;
- një kopje të certifikatës/diplomës së arsimit të lartë përkatës;
- një kopje të certifikatës/diplomës së arsimit të ciklit të dytë të fushës përkatëse;
- certifikatë në origjinal e punësimit të rregullt dhe përvojë pune përkatëse prej të paktën 3 vjetësh si mësimdhënës i lëndës përkatëse, lëshuar nga shkollat e mesme në RMV ose si pjesë e kuadrit mësimor-shkencor ose profesional nga universitetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut për lëndën përkatëse, përkatësisht fushën përkatëse, lëshuar nga universitetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- kopje të ballinës së punimeve të publikuara profesionale, përkatësisht punimeve shkencore të cilat janë në funksion të fushës përkatëse.

IV. Qendra Shtetërore e Provimeve do të bëjë përzgjedhjen sipas kriterëve të mësipërme, ndërsa me kandidatët që plotësojnë kushtet e përcaktuara në konkurs do të zhvillohet një intervistë, përveç te kandidatët për përkthyes të materialeve të provimit, ku para intervistës, komisioni fillimisht do të bëjë verifikimin e kandidatëve lidhur me njohjen e gjuhës burimore (gjuhën nga e cila po përkthehet materiali) dhe gjuhën e synuar (gjuhën në të cilën po përkthehet materiali) ndërsa vetëm kandidatët të cilët do të kalojnë verifikimin për njohjen e gjuhës do të ftohen në intervistë, më pas do të vijojë përzgjedhja përfundimtare.

V. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm - përkthyes dhe lexues të pavarur për nevojat e maturës shtetërore bëhet në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

VI. Kandidatët që do të përzgjidhen si bashkëpunëtorë të jashtëm - përkthyes dhe lexues të pavarur për nevojat e maturës shtetërore do të angazhohen **deri në fund të vitit shkollor 2025/2026**.

VII. Afati për aplikim të kandidatëve të interesuar është përfundimisht me 24.04.2025.

VIII. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të kryhet më së voni 18 (tetëmbëdhjetë) ditë pas përfundimit të afatit të aplikimit.

IX. Dokumentacioni i dërguar me vonesë, i pakompletuar dhe i pavlefshëm nuk do të merret në konsideratë.

X. Aplikimi i plotësuar me dokumentacionin e kërkuar dorëzohet në Arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve (nga ora 10:00 deri në ora 14:00) ose me postë rekomandë, në adresën: Qendra Shtetërore e Provimeve - Shkup rr. "Vasil Gjorgov" p.n.1000 Shkup, me shënimin **"Për konkursin publik për bashkëpunëtorë të jashtëm – përkthyes dhe lexues të pavarur"**.

XI. Informacione shtesë për konkursin publik mund të merren në numrin e telefonit 076/484-739, çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 14:00.

QENDRA SHETETËRORE E PROVIMEVE SHKUP